



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 136, datë 30.09.2020**

**PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË TË SIGURIMIT  
“ALBSIG JETË” SH.A**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 57, të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e ndryshimit të nenit 5, pika 1, të statutit të shoqërisë “Albsig Jetë” sh.a., si rezultat i rritjes së kapitalit, si më poshtë:**

**“5.1. Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i shoqërisë është 432,254,000 lekë (katërqind e tridhjetë e dy milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë) lekë, i cili përbëhet nga 432,254 (katërqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 1,000 (një mijë) lekë secili. Kapitali është nënshkruar dhe paguar si më poshtë:**

**Shoqëria Albsig” sh.a. zotëron 432,254 (katërqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) aksione të cilat përbëjnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë”.**

- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**